



## Thirrje për aplikim

### Pozita: Zyrtar/e i/e terrenit dhe trajner/e

Brenda projektit Social Act, të financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), PEN synon ta punësoj një zyrtar/e të terrenit (trajner/e).

**Afati për aplikim:** 22 nëntor 2018

**Periudha e fillimit të punës:** 1 dhjetor 2018

**Kohëzgjatja e kontratës:** 5 muaj

**Komuna:** Prishtinë

### Qëllimi i projektit

Ngritja e kapaciteteve të rinjëve dhe të rejave në të menduarit kritik, shkathtësi avokuese, shkathtësi të buta (soft skills), dhe në përpilimin dhe udhëheqjen e inovacioneve sociale që synojnë gjithëpërfshirjen sociale në Kosovë, me theks të veçantë në barazinë gjinore dhe gjithëpërfshirjen e grupeve të minoriteteve.

### Detyrat për këtë pozitë do të përfshijnë:

- Udhëheqja e trajnimeve të projektit
- Organizimi i takimeve me përfaqësues komunal
- Zhvillimi i materialeve të projektit
- Mbështetje me dizajnimin dhe organizimin e ngjarjeve të projektit
- Monitorimi dhe zbatimi i iniciativave lokale
- Menaxhimi i informatave dhe i komunikimit pro-aktiv, të vazhdueshëm dhe efektiv me përfituesit dhe akterët kyç lokalë
- Vizitat e rregullta monitoruese në komunat e përfituesve

### Aftësitë e kërkuara dhe përvoja:

- Të jetë i/e diplomuar në Shkenca Sociale apo fusha të ngjajshme
- Të ketë përvojë pune së paku 3 vjeçare në mobilizim dhe trajnim të komuniteteve lokale
- Të ketë përvojë pune së paku 2 vjeçare në rrjetëzimin e përfaqësuesve institucional lokal
- Të ketë njohuri të mira në çështje të gjithëpërfshirjes sociale
- Të ketë njohuri të mira në çështjet e lidërshiptit dhe vendimmarrjes në nivel lokal
- Të ketë aftësi për të punuar individualisht me pak mbikëqyrje dhe si pjesë e ekipës
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit në gjuhën shqipe
- Të jetë i/e gatshme të punoj edhe jashtë Prishtinës sipas nevojës
- Të jetë i/e gatshme të punoj në mjedis dinamik të punës
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme kompjuterike
- Të posedoj patentën e shoferit – Kategoria B (E preferueshme)



## PËR RINI TË FUQIZUAR



### **Procedura e aplikimit:**

Të gjithë kandidatët/et e interesuar për këtë pozitë duhet të dërgojnë CV dhe një letër motivimi në adresën elektronike [apliko@ngo-pen.com](mailto:apliko@ngo-pen.com) deri më **22 nëntor 2018** jo më vonë se në orën **17:00**, duke e potencuar në subjekt **Aplikim për pozitën Zyrtar/e i/e terrenit dhe trajner/e – Projekti Social Act.**

Vetëm kandidatët/et e suksesshëm/e do të njoftohen për intervistë.